



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0365**

**OSHP: 2024/0375**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim- Kryesuese, Kimete Gashi-Brajshori, dhe Vedat Poterqoi-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së OE PBC SH.P.K., dhe OE RENER SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit për lot I dhe për anulim të aktivitetit të prokurimit për lot II, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës se Prishtinës., më 05.08.2024, me shumicë votash mori këtë:

## **Vendim**

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesat e OE PBC SH.P.K., me nr. 2024/0365 e datës 26.04.2024, si dhe ankesa e OE “RENER” SH.P.K., me nr. 2024/0375 e datës 29.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës se Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës se Prishtinës, për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit për lot I dhe për anulim të aktivitetit të prokurimit për lot II, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit 616-24-97-2-1-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

### ***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 10.01.2024, Kuvendi i Komunës se Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1". Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës se Prishtinës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim. Vlera e parashikuar për të dy pjesët është 335,000.00 euro.

Me 08.04.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku shpërblen me kontratë për lot I OE “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K., ndërsa për lot II anulon aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me 12.04.2024, Operatorët Ekonomik PBC SH.P.K., dhe “RENER” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi dhënie për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1" për lot I të cilën AK i ka refuzuar si të pabazuara me datën 17.04.2024.

Me datë 29.02.2024 OE PBC SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Anulim të aktivitetit të prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1" për lot II Autoritetit Kontraktues hedh posht si të palejuar këtë kërkesë me datën 04.03.2024.

Me datë 28.02.2024 OE “RENER” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Anulim të aktivitetit të prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1" për lot II Autoritetit Kontraktues miraton si të bazuar këtë kërkesë me datën 04.03.2024.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues PBC SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2024/0365 e datës 26.04.2024, si dhe OE ankues “RENER” SH.P.K., ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0375 të datës 29.04.2024.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2024/0365 dhe ankesa nr. 2024/0375 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr.

01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

*Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesve PBC SH.P.K. dhe "RENER" SH.P.K për aktivitetin e prokurimit për lot I.*

Kërkesa e "PBC" Sh.P.K. u hodh poshtë si e pabazuar pasi kërkesa për "njësi mësimore të vendosura në një bibliotekë digjitale" ishte pjesë e dosjes së tenderit dhe nuk është kontestuar nga parashtruesi. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar për shkak të mos përmbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara.

Kërkesa e "Rener" Sh.P.K. pretendon se nuk ka pasur kërkesa për specifikimet teknike të kontestuara në dosjen e tenderit. Megjithatë, analiza ka konfirmuar se këto specifikime ishin të pranishme dhe të qarta në dosje. Kërkesa për rishqyrtim e "Rener" Sh.P.K. është refuzuar pasi nuk ishin paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tyre.

*Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesve PBC SH.P.K. dhe "RENER" SH.P.K për aktivitetin e prokurimit për lot II.*

Operatori ekonomik "PBC" Sh.P.K. paraqiti një kërkesë për rishqyrtim më 29.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 për aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo - arsimore - ritender". Kërkesa e parashtruesit u dorëzua jashtë afatit të përcaktuar, sipas nenit 60, paragrafin 60.1, nënparagrafin c) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dhe u hodh poshtë si e palejuar.

Operatorët ekonomikë "Schoolme Implementation & Consulting" dhe "Rener" Sh.P.K. paraqitën kërkesa për rishqyrtim më 28.02.2024, brenda afatit të përcaktuar dhe u gjetën të lejuara për shqyrtim.

Autoriteti Kontraktues kishte anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyen se ofertat e dorëzuara nuk përputheshin me kurrikulën e re të arsimit në Republikën e Kosovës. "Schoolme Implementation & Consulting" pretendon se oferta e saj ishte në përputhje të plotë me kurrikulën e re, ndërsa "Rener" Sh.P.K. argumenton se nuk ishte kërkuar një përputhje të tillë në dokumentacionin e tenderit.

Pas shqyrtimit, është konstatuar se komisioni vlerësues nuk kishte bërë një ekzaminim dhe vlerësim të plotë të tenderëve dhe nuk kishte ofruar një sqarim të detajuar për anulimin e aktivitetit. Kërkesat për rishqyrtim të "Schoolme Implementation & Consulting" dhe "Rener" Sh.P.K. janë miratuar si të bazuara dhe është kërkuar rivlerësimi i ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren përkatëse.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PBC SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:*

Operatori ekonomik ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë kundër vendimeve të datës 08 dhe 18 prill 2024 nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore ritender lot 1". Në kërkesën për rishqyrtim, kritika kryesore është se Autoriteti Kontraktues ka bërë një ndryshim substancial në kriteret e kualifikimit, duke përfshirë kërkesa të reja që nuk janë specifikuar në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Këto kërkesa të reja për "përmbajtje të njërive mësimore" dhe "bibliotekë digjitale" nuk janë përmendur në dokumentet e tenderit dhe përbëjnë shkelje të ligjit për prokurim publik dhe rregulloreve përkatëse. Prova për këtë përfshin Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe dokumentet përkatëse që janë nënshkruar dhe vulosur. Në ankesën ndaj vendimit të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim,

kritika është se ky vendim përpiqet të ndryshojë arsyetimin nga "mos përmbushja e specifikimeve teknike të detyrueshme" në "mos përmbushja e specifikimeve teknike në paramasa" (tabela e çmimeve), duke shkelur paragrafin 1 të nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik. Prova për këtë përfshin vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe dokumentet përkatëse që ilustrojnë mos përputhjen e pretenduar. Kërkohej që Organi Shqyrtues i Prokurimit të obligojë Autoritetin Kontraktues të anulojë vendimet e datës 08 dhe 18 prill 2024 dhe të rivlerësojë ofertat për të dy lotët në përputhje me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, siç parashikohet nga Ligji për Prokurim Publik.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "RENER" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:*

Në Vendimin e datës 18/04/2024, për tenderin "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-tender lot I", Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloret përkatëse. AK ka devijuar nga kërkesat ligjore duke mos trajtuar siç duhet kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 12.04.2024, duke ofruar një arsyetim të gabuar dhe duke shpërfillur provat që kemi paraqitur, si Aneksi 1 dhe specifikimet teknike të detyrueshme. Vendimi i AK për refuzimin e kërkesës sonë është në kundërshtim me nenet 7, 51, 54, 56 dhe 108/A, par. 6 të LPP-së, duke krijuar një situatë lajthitëse dhe duke shpërfillur pretendimet tona. AK gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me nene të tjera të LPP-së, duke përfshirë nenet 6, 62 dhe 63, duke shkelur rregullat e vlerësimit të tenderëve dhe duke mos marrë parasysh pretendimet tona lidhur me shpërbllimin e kontratës dhe anulimin e LOT II. AK ka përdorur një arsyetim të gabuar që çmimi është determinues për eliminimin e operatorëve, në kundërshtim me LPP-në dhe rregulloret përkatëse, duke bërë që vendimi të jetë i paligjshëm.

#### ***-Vlerësimi dhe administrimi i provave-***

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i prokurimit me datë 16.05.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0365 dhe për ankesën me nr. 2024/0375 ndërsa me datë 18.05.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0365 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: "eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të trajtohet si pjesërisht e bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së".

*Konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 2024/0365 të operatorit ekonomik PBC SH.P.K.*

Eksperti fillimisht sqaron se në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka precizuar si arsyetimin për eliminim: "Nuk ju keni përmbajtur specifikimet teknike të detyrueshme në Aneksin 1." Ndërsa në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka ndërruar arsyetimin duke konstatuar se kërkesat janë të vendosura në dokumentin e listës së çmimeve/paramasën, përkundër që në nenin 54 të LPP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 thuhet: "...në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë." Në një situatë të tillë, AK ka bërë shkelje procedurale për shkak se OE ankues i cenohet e drejta për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë AK-së dhe pastaj ankimimin në OSHP ashtu sikurse precizohet me nenin 108/A.

Ndërkaq, lidhur me çështjen se kërkesat e vendosura në listën e çmimit nuk janë kërkesa të dosjes së tenderit, Eksperti sqaron se në nenin 17, paragrafi 2, i Rregullores për Prokurimin Publik (RrPP), përcaktohet se struktura e dosjes së tenderit përbëhet nga tri pjesë: Pjesa A – Procedura e tenderimit, Pjesa B – Draft Kontrata dhe Pjesa C – Formulari i Tenderit. Më tej në paragrafin 7 të nenit të sipërpërmendur specifikohet se Pjesa C e dosjes së tenderit përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve. Në lidhje me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, në nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.” Gjithashtu, në nenin 40, paragrafi 6 i RrPP thuhet: tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Andaj, duke marrë për bazë sqarimin e mësipërm është e qartë që formulari i çmimit është pjesë e dosjes së tenderit, rrjedhimisht të gjitha kërkesat e përcaktuara edhe në formularin e çmimit si pjesë e dosjes duhet të merren për bazë në mënyrë që të vlerësohet përgjegjshmëria e tenderuesve.

Si përfundim, Eksperti sqaron se secila arsye e eliminimit duhet të precizohet saktë në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar dhe duhet t'i jepet mundësia OE-ve që të realizojnë të drejtën e kërkesës për rishqyrtim për arsyet e eliminimit. Më tej, në rrethana sikurse është sqaruar më sipër, ku në listën e çmimeve janë vendosur kërkesa që duhet të ofrohen nga ofertuesit në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, dhe faktit që OE ankues në ofertë dhe në këtë ankesë nuk ka dorëzuar dëshmi përkatësisht provë mbështetëse në lidhje me kërkesat e përcaktuara në listën e çmimeve, edhe në rast të rivlerësimit të tenderit do të konstatohej mospërmbushja e kërkesave. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

*Konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 2024/0375 të operatorit ekonomik “RENER” SH.P.K.*

Eksperti fillimisht sqaron se në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka precizuar si arsyetim për eliminim: “Nuk ju keni përmbushur specifikimet teknike të detyrueshme në Aneksin 1.” Ndërsa në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka ndryshuar arsyetimin duke konstatuar se kërkesat janë të vendosura në dokumentin e listës së çmimeve/paramasën. Kjo përbën një shkelje procedurale, për shkak se OE ankuesit i është cenuar e drejta për të paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së dhe pastaj ankimimin në OSHP, ashtu siç është precizuar në nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Për më tepër, OE ankues kishte dorëzuar dokumentin me kërkesat e Aneksit 1, të nënshkruar dhe vulosur.

Në lidhje me pretendimin se kërkesat e vendosura në listën e çmimeve nuk janë kërkesa të dosjes së tenderit, Eksperti sqaron se, sipas nenit 17, paragrafi 2, i Rregullores për Prokurimin Publik (RrPP), struktura e dosjes së tenderit përbëhet nga tri pjesë: Pjesa A – Procedura e tenderimit, Pjesa B – Draft Kontrata dhe Pjesa C – Formulari i Tenderit. Më tej, në paragrafin 7 të nenit të sipërpërmendur specifikohet se Pjesa C e dosjes së tenderit përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve. Në lidhje me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, në nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të

përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Gjithashtu, në nenin 40, paragrafi 6 i RrPP thuhet: Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në terma teknikë me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosjen e tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit. Andaj, duke marrë për bazë sqarimin e mësipërm, është e qartë që formulari i çmimit është pjesë e dosjes së tenderit, dhe rrjedhimisht të gjitha kërkesat e përcaktuara në formularin e çmimit si pjesë e dosjes duhet të merren për bazë në mënyrë që të vlerësohet përgjegjshmëria e tenderuesve.

Si përfundim, Eksperti sqaron se në aspektin procedural secila arsye e eliminimit duhet të precizohet saktë në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar dhe duhet t'i jepet mundësia OE-ve që të realizojnë të drejtën e kërkesës për rishqyrtim për arsyet e eliminimit. Më tej, në rrethana sikurse është sqaruar më sipër, ku në listën e çmimeve janë vendosur kërkesa që duhet të ofrohen nga ofertuesit në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, dhe faktit që OE ankues në ofertë dhe në këtë ankesë nuk ka dorëzuar dëshmi përkatësisht provë mbështetëse në lidhje me kërkesat e përcaktuara në listën e çmimeve, edhe në rast të rivlerësimit të tenderit do të konstatoheshin të njëjtat mospërmbushje të kërkesave. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa Operatori ekonomik nuk është pajtuar.

Kryesuesja e panelit shqyrtues pas analizimit të fakteve dhe rrethanave dhe vlersimit të raportit të ekspertit ka kërkuar përmes postës elektronike sqarime shtesë duke ju referuar përgjigjeve të palëve ankuese në raport të eksperizave me nr 2024/0365 të datës 16.05.2024, dhe 2024/0375 të datës 18.05.2024 nga eksperti, ku eksperti ka dhënë përgjigje shtesë si në vijim:

Fillimisht, në lidhje me vendimin e AK-së të datës 08.04.2024, është e qartë që AK kishte bërë një konstatim të gabuar të gjendjes faktike, për faktin se OE-të kishin plotësuar kërkesat e Aneksit 1 të dosjes së tenderit. Ndërsa në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK kishte vendosur si arsye të refuzimit kërkesat e përcaktuara në formularin e çmimit.

Më tej, lidhur me kërkesat e vendosura në listën e çmimeve, sqaroj se në nenin 17.12 të Rregullores për Prokurimin Publik (RrPP), ndër të tjera përcaktohet se: "...Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike". AK kishte vendosur kërkesat që ishin arsye të eliminimit vetëm në formularin e çmimit. Megjithatë, në nenin 17.7 përcaktohet se "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga: - Formulari i tenderit - Lista e çmimeve."

Tutje, në nenin 40.6 përcaktohet se "Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në terma teknikë me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit."

Në fund, referuar kërkesës , duke marrë për bazë nenet 1, 6 dhe 7 të LPP-së, përkatësisht dallimin në çmim, në rast të rivlerësimit, sqaroj se, konform nenëve 59 dhe 72 të LPP-së, AK mund të ftojë operatorët ekonomikë për të plotësuar ose të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -***

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave sipas ankesave të dorëzuar me numër protokolli Nr. 2024/0365 dhe 2024/0375 sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues PBC SH.P.K., dhe “RENER” SH.P.K., i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues të datës 16.05.2024 sipas nr të lëndës 2024/0365 , dhe 18.05.2024 , nr i lëndës 2024/0375. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të papazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues me shumicë votash ka vendosur ta lejë në fuqi vendimin e AK, saktësisht njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1" për lot I dhe njoftimin për anulim të kontratës të për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore-ritender” me numër të prokurimit: "616-24-97-2-1-1" për lot II.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - PBC SH.P.K., " RENER " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: